



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



KA/Nr. 2899/20
Datë: 23/11/2020

Komisioni i Ankesave në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, i themeluar me Vendimin Nr.1448/20D, të datës 04.09.2020, në përbërje të Faton Merovci, Muhamet Qerimi, Krenare Sogojeva Dërmaku, në shqyrtimin e lëndës administrative, respektivisht ankesës së Kolegjit Rezonanca, nr.prot. 654/20H, e datës 29.06.2020, kundër Vendimit të KSHC nr. ref. 574/202D, i datës 22.06.2020 për refuzimin e akreditimit të programit Mjekësi e Përgjithshme, e pranuar më datë 23.10.2020, në mbështetje të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e datës 05.11.2020, me votim unanimit, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e Kolegjit Rezonanca nr.prot. 654/20H, datë 29.06.2020 dhe vërtetohet Vendimi i KSHC-së nr. ref. 574/202D, datë 22.06.2020.

ARSYETIM

Kolegji Rezonanca më datë 29.06.2020, brenda afatit ligjor ka parashtruar Ankesë/Kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, përmes së cilës ka kërkuar që Këshilli Shtetëror i Cilësisë të rishqyrtoj vendimin e tij nr. ref. 574/202D, i datës 22.06.2020, me të cilin është refuzuar kërkesa për akreditimin e programit Mjekësi e Përgjithshme. Pala me Ankesën/Kërkesën nr.prot. 654/20H, e datës 29.06.2020 pretendon se:

Gjatë shqyrtimit të aplikacionit për programin Mjekësi e Përgjithshme, Këshilli Shtetëror i Cilësisë nuk ka poseduar dokumentacionin shtesë të dorëzuar, për shkak të humbjes së këtij dokumentacioni nga AKA.

Më tutje pala ka sqaruar se në takimin konsultativ të mbajtur në mes KSHC dhe Kolegjit Rezonanca me datë 07.02.2020, lidhur me aplikacionet për vitin 2020/2021, Kolegji Rezonanca është njoftuar me kriteret e reja lidhur me akreditimin e programit Mjekësi e Përgjithshme, ku ka marrë obligimin për plotësimin e dokumentacionit shtesë për Dr. sc. Agim Krasniqi, Dr. sc. Fatos Kelmendi dhe Dr. sc. Gazmend Zhuri. Me datën 12.03.202, është bërë dorëzimi në AKA

i dokumentacionit shtesë si në versionin elektronik, ashtu edhe në versionin fizik për statusin e punësimit të tre profesorëve të lartcekur.

Sipas pretendimit të palës, gjatë shqyrtimit të aplikacionit nga ana e KSHC, ky dokumentacion nuk është prezantuar, për shkak të humbjes së tij nga AKA. Pas njoftimit nga AKA se dokumentacioni ka humbur, Kolegji Rezonanca më datë 19.05.2020 e ka dorëzuar përsëri të njëjtin me hipërlidhje në dy adresa elektronike tek zyrtarët e AKA-së.

Provat e administruara:

- Vendimi i KSHC-së nr. ref. 574/202D, i datës 22.06.2020;
- Shkresa e datës 12.03.2020 për dorëzimin e aplikacionit;
- Shkresa elektronike e datës 19.05.2020 për ridërgimin e dokumentacionit;
- Kontrata e punësimit të Dr.sc. Agim Krasniqi, Dr. sc. Fatos Kelmendi dhe Dr. sc. Gazmend Zhuri;
- “Screen Shoot” e ëeb-faqes së E-akreditimit për deklarinimin e stafit;
- Raporti i KSHC-së për rishqyrtimin e ankesës nga takimi i datës 02.09.2020.

Shpjegim i situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi

Komisioni i Ankesave në AKA, ka pranuar ankesën/kërkesën nr.prot. 654/20, e datës 29.06.2020 e Kolegjit Rezonanca më datë 23.10.2020, së bashku me dokumentacionin dhe Raportin e KSHC-së për rishqyrtimin e ankesës, nga takimi i datës 02.09.2020, me të cilën ka përshkruar pretendimin e palës dhe arsyen e refuzimit të kërkesës për akreditim.

Komisioni i Ankesave, pas shqyrtimit të ankesës dhe provave të bashkëngjitura ka gjetur se KSHC fare nuk është lëshuar në mos-prezantimin e dokumentacionit plotësues të Kolegjit Rezonanca nga AKA, por KSHC ka konstatuar se:

Për programin Mjekësi e Përgjithshme në nivelin bachelor dhe master që ka 360 ECTS, duhen 6 profesorë me orar të plotë si bartës programi, pra për çdo 60 ECTS një profesor me titullin shkencor Doktor Shkence, ashtu siç e parashih edhe neni 26, paragrafi 5.3.4, i Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë.

KSHC pas verifikimit të dokumentacionit, deklaroi se Dr.Sc. Gazmend Zhuri nuk ka figuruar i deklaruar si i angazhuar me orar të plotë në vitin akademik 2019/2020 në platformën e-akreditimi. Mbi këtë bazë, të njëjtin e ka larguar nga lista e profesorëve të rregullt si bartës programi, pas së cilës Kolegji Rezonanca nga 6 profesorë të paraqitur fillimisht, ka mbetur me vetëm 5 profesorë të rregullt të cilët i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë bartës për programin Mjekësi e Përgjithshme me 360 ECTS.

Shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave

Komisioni i Ankesave, pasi ka konstatuar se ankesa e Kolegjit Rezonanca është parashtruar brenda afatit kohor, ka shqyrtuar pretendimet e palës për mos-akreditim të programit, mbi bazën se AKA nuk ka prezantuar dokumentacionin shtesë të dërguar më datë 12.03.2020, ka gjetur se:

Vendimi i KSHC në arsyetimin e tij nuk është lëshuar në mos-prezantim të dokumentacionit, por vetëm në faktin se Dr.Sc. Gazmend Zhuri nuk ka figuruar i deklaruar si i angazhuar me orar të plotë në vitin akademik 2019/2020 në platformën e-akreditimi.

Komisioni i Ankesave e ka verifikuar deklarin e Dr.Sc. Gazmend Zhuri në platformën e-akreditimi për vitin 2019/2020 dhe prej aty shihet qartë se i njëjti ka qenë vetëm "part time" (orar jo të plotë) në këtë Kolegj gjatë vitit 2019/2020. E njëjta mund të vërtetohet përmes "screen shoot" të marrë nga kjo platformë.

Baza ligjore e vendimit dhe arsyeja pse është e zbatueshme në rastin konkret

Neni 26, paragrafi 5.3.4 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, përcakton se: *"Për programet e studimit të cilat shpijen deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për një grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit."*

Nga kjo, derisa është provuar se prof. Gazmend Zhuri nuk ka figuruar i deklaruar si i angazhuar me orar të plotë në vitin akademik 2019/2020 në platformën e-akreditimi, dhe është hequr nga lista prej gjashtë profesorëve si bartës i programit për Mjekësi të Përgjithshme, me çka edhe nuk janë përmbushur kërkesat ligjore sipas nenit 26, paragrafin 5.3.4. të UA 15/2018 për akreditimin e IAL-ve të, Komisioni i Ankesave vlerëson se mbi këtë bazë ligjore ka arsyeshmëri të plotë Vendimi i KSHC-së nr. ref. 574/202D, i datës 22.06.2020.

Pala me datë 29.10.2020, ka qenë e ftuar nga Komisioni i Ankesave për ta ushtruar të drejtën e vet për tu dëgjuar, ashtu siç e parasheh nenin 95 i Ligjit Nr.05/L-03/ për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Këtë të drejtë nuk e ka realizuar Kolegji Rezonanca, e as nuk ka parashtruar ndonjë provë apo argument shtesë.

Në përfundim,


Komisioni i Ankesave pasi shqyrtimit dhe administrimit të provave, vërtetimit të gjendjes faktike dhe legjislacionit në fuqi, mbi bazën e kompetencave të dhëna me nenin 22, paragrafin

3 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Komisioni i Ankesave në AKA

KA/Nr. 2899/20, datë 23/11/2020

Procesmbajtësi


Arianit Krasniqi

Kryetari i Komisionit të Ankesave


Faton Merovci



Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditëve në gjykatën kompetente për konfliktet administrative.